



## MBI PROGRAMIN KOMBËTAR TË BURSIVE PËR SHKËMBIME AKADEMIKE

### NË SLOVAKI, VITI AKADEMIK 2018-2019

Qeveria e Republikës së Sllovakisë ka shpallur **Programin Kombëtar të Bursave të Republikës së Sllovakisë** (National Scholarship Program-NSP of the Slovak Republic) për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të kryejnë studime, kërkime pranë universiteteve sllovaqe, organizatave kërkimore, institucioneve të artit, etj. Ky program synon të mbështesë me bursë shkëmbimet e studentëve të huaj universitarë dhe pasuniversitarë, të doktoratës, pedagogeve të universitetit, studiuesve dhe specialistëve, etj. (me kohëzgjatje nga 1-10 muaj) për vitin akademik 2018-2019, në programet e studimit:

- **Master (1-2 semestra):** Të gjithë të interesuarit duhet të jenë të pajisur me një diplomë Bachelor ose të kenë kryer të paktën 3 vite studime universitare në një Universitet të akredituar jashtë Sllovakisë.
- **Doktoratë/ Postdoktoratë/Lektorë/Kërkues/Artist (1-10 muaj);**

Programi financohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Kërkimit dhe Sportit të Republikës së Sllovakisë dhe administrohet nga Agjencia Sllovaqe për Informacionin Akademik (Slovak academic Information Agency, SAIA).

Procedura e aplikimit realizohet dy herë në vit (në pranverë dhe vjeshtë). Afati i fundit i aplikimit për pranimet në vjeshtë 2018 është data **31 tetor 2018 ora 16:00**, ndërsa për pranimet në pranverë 2019 është data **30 prill 2019**. Aplikimi realizohet online: [www.scholarships.sk](http://www.scholarships.sk).

Modalitetet lidhur me mbulimin e shpenzimeve përcaktohen pasi kandidatët të jenë pranuar nga universitetet përkatëse sllovaqe për ndjekjen e studimeve në bazë të kualifikimit që ata kanë.

Përzgjedhja e kandidatëve behet nga një Komision i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Kërkimit dhe Sportit të Republikës së Sllovakisë.

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të degëve studimore, si dhe informacione të tjera rreth programit gjenden në faqen zyrtare të internetit:

<https://www.scholarships.sk>

<https://www.scholarships.sk/en/news/summer-semester-academic-year-2018-2019-apply-now>

<https://www.scholarships.sk/en/main/programme-terms-and-conditions/foreign-applicants>;

Gjithashtu, për pyetje në lidhje me Programin e Bursave Kombëtare kandidatët mund të kontaktojnë direkt me z. Lukáš Marcin, koordinator i këtij programi në adresën elektronike:

[lukas.marcin@saia.sk](mailto:lukas.marcin@saia.sk);

## DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS